



BASHKIA MIRDITË
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
GUSHT 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	30.07.2024	Kërkesë për Informacion	12.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, drejtuar Bashkisë Mirditë, nëpërmjet postës elektronike, bazuar në Ligjin nr.119/2014 për të Drejtën e Informimit ju informojmë se:</p> <p>Bashkia Mirditë është në proces të hartimit të Plan Veprimit për Eficiencën e Energjisë si pjesë e projektit EFFORT, një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA Crossborder Shqipëri-Kosovë me një bashkëpunim ndërmjet Co-PLAN, Bashkisë Mirditë, Shqipëri dhe Komunës Junik, Kosovë.</p> <p>Për arsye financiare nuk është hartuar më parë.</p>	E plotë	Pa pagesë
2.	01.08.2024	Kërkesë për Informacion	12.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, drejtuar Bashkisë Mirditë, nëpërmjet postës elektronike, bazuar në Ligjin nr 119/2014 për të Drejtën e Informimit ju informojmë:</p> <p>1. A keni investuar në sistemin vadtës? Nëse po, cila është vlera e investimit për periudhën 2014-2024?</p>	E plotë	Pa pagesë

Nga bashkia Mirditë është investuar në sistemin ujitës dhe konkretisht:

a) Rehabilitimi i kanalit ujitës Ndërfushas, me një vlerë prej 8 072 758 lekë, në vitin 2017, por që nuk është marrë në dorëzim përfundimtar investimi i realizuar. ?

Ky kanal ujitës furnizohet nga rrjedha e lumit Fan i Vogël, në fshatin Ndërfanë.

b) Blerje tuba të korruguar për ujitje për rehabilitimin e kanaleve dhe vijave ujitëse në njësitë administrative Fan, Orosh, Kaçinar, Rubik, Rrëshen dhe Selitë, në vlerën rreth 6 800 000 lekë, në vitet 2016 dhe 2023.

c) Rehabilitim i kanalit ujitës Fang, me një vlerë prej 6 180 000 lekë, në vitin 2022

2. Sa HEC-e janë ndërtuar dhe operojnë në bashkinë tuaj?

Sa është vlera e taksave që vlin nga operimi i kompanive koncensionare të HEC-eve në bashkinë tuaj?

- Në territorin e bashkisë Mirditë janë ndërtuar dhe operojnë 9 (nëntë) Hec-e. Përsa u përket HEC-eve që operojnë në Bashkinë Mirditë, jo të gjithë janë me kontratë. Për HEC-et që operojnë me kontratë me bashkinë Mirditë dhe nuk kanë seli në Mirditë, përveç vlerës së kontratës aplikohet një tarifë prej 400,000 lekë për pastrim dhe shfrytëzim pasurie.

- HEC-et që janë me seli në Mirditë paguajnë tarifën dhe taksat si biznes përveç vlerës së kontratës. Vlera e tarifave që faturohen për taksë dhe tarifa vendore nga HEC-et është 5,800,000 lekë.

3. Si kanë ndikuar këto HEC-e në ekonomin lokale dhe veçanarisht në bujqësi?

- Ndikimi i hec-eve në ekonomin lokale është nëpërmjet vjeljes së taksës, punësimit të banorëve të zonës dhe veçanarisht në bujqësi nuk ka impakt negativ.

				<p>4. Si i menaxhoni ankesat e banorëve për mungesën e ujit për vadijtje? Cilat institucione keni vënë në dijeni për mosrespektimin e kriterit të lënjes së rrjedhjes së lirë të lumit? -Bashkëngjitur gjeni përgjigjen.</p>		

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!